

KËSHILLI STATISTIKOR

Rekomandimet (në takimin XIV) të Këshillit Statistikor

Nga diskutimet në mbledhjen e 14-të të Këshillit Statistikor, u nxorën një varg rekomandimesh:

- Ligji për Statistika Zyrtare që është në proces të plotësimit-ndryshimit, ta definojë çartë pavarësinë e ASK-së, ta fuqizojë pozicionin e saj si institucion si dhe ta ndihmojë që të rritet transparenca.
- Harmonizimi sa më i madh me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
- Krijimi i një sistemi të integruar të statistikave zyrtare në aspektin e TI-së dhe proceseve prodhuese.
- Të forcohet roli i KS në përmirësimin e gjendjes së statistikave zyrtare dhe në rritjen e koordinimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.
- Të gjenden mënyra për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të ASK-së, për të përmbushur kërkesat që shtrohen në vazhdimësi nga ndikimi i teknologjisë në procesin e punës.
- Të rriten aktivitetet për informimin dhe orientimin sa më efikas dhe më eficient të përdoruesve.
- Ofrimi sa më i madh i shërbimeve online dhe orientimi i shfrytëzuesve për t'i përdorur ato.
- Finalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në nivel institucional sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe rritja e kontrollit të cilësisë së produkteve statistikore.
- Përmirësimi në vazhdimësi i cilësisë tek proceset të cilat gjenerojnë të dhëna statistikore.
- Rritja e numrit të indikatorëve statistikorë të prodhuar, të theksuar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, sidomos atyre ekonomike.
- Pavarësisht sfidave që ndërlidhen me statusin politik të Kosovës, të kërkohen mundësitë që të dhënat për Kosovën të publikohen në data-bazat ndërkombëtare, me theks të veçantë në UNSTAT.
- Vazhdimi i ndërkombëtarizimit të statistikave të Kosovës.
- Është kërkesë shumë e ngutshme përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të punës për stafin e ASK-së.